



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.105

11 gusht

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 302 datë 15.7.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar	5277
Ligj nr.10 303 datë 15.7.2010	Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve	5279
Ligj nr.10 305 datë 22.7.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar”	5284
Vendim i Kuvendit nr.51, datë 22.7.2010	Për emërimin e një anëtari të bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri	5290
Vendim i Kuvendit nr.52, datë 22.7.2010	Për emërimin e një anëtari të bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri	5290
Vendim i Kuvendit nr.53, datë 22.7.2010	Për emërimin e një anëtari të bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri	5291
Vendim i Kuvendit nr.54, datë 22.7.2010	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit	5291
Vendim i Kuvendit nr.55, datë 22.7.2010	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit	5292
Vendim i Kuvendit nr.56, datë 22.7.2010	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit	5292

LIGJ
Nr.10 302, datë 15.7.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8308, DATË 18.3.1998
“PËR TRANSPORTET RRUGORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen shtesat dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 3.18 pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) dokument që i jep të drejtën një mjete për transportin e udhëtarëve, për llogari të vet, brenda dhe jashtë vendit.”.

2. Në pikën 3.21, fjalët “me anë të një mjete ose kombinimi mjetelesh motorike” zëvendësohen me fjalët “me anë të mjeteve motorike ose kombinimeve të mjeteve.”.

3. Pas pikës 3.24 shtohet pika 3.25 me këtë përmbajtje:

“3.25. Kabotazhi është operacioni i transportit të udhëtarëve ose të mallrave, të ngarkuara në një pikë të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe shkarkimin e tyre në një pikë tjetër të territorit të Republikës së Shqipërisë, me anë të një mjete të regjistruar në territorin e një shteti tjetër.”.

Neni 2

Në nenin 5 paragrafi i tretë, fjalët “e transportit të mallrave për vete” zëvendësohen me fjalët “e transportit të mallrave dhe udhëtarëve për vete.”.

Neni 3

Në nenin 8 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Licenca për veprimtarinë e transportit pezullohet ose hiqet, kur:”.

2. Në fund të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Procedurat për pezullimin dhe heqjen e licencës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Në nenin 35 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, emërtimi “Këshilli bashkiak” zëvendësohet me emërtimin “Këshilli bashkiak ose komunal.”.

2. Paragrafi i dytë shfuqizohet.

3. Paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Licenca për shërbimin taksi jepet nga kryetari i bashkisë ose i komunës përkatëse, në përputhje me rregullat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 36 paragrafi i dytë, emërtimi “Këshilli bashkiak” zëvendësohet me emërtimin “Këshilli bashkiak ose komunal.”.

Neni 6

Neni 46 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 46

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg.”.

Neni 7

Pas nenit 52 shtohet neni 52/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 52/1

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 2 të këtij ligji, ministri lejon kryerjen e transportit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga një transportues i huaj (kabotazh), që nuk e ka selinë në Shqipëri, edhe kur nuk parashikohet në marrëveshjen ndërkombëtare me shtetin, ku transportuesi i huaj ka selinë, vetëm për arsye të emergjencës civile dhe zgjat për sa kohë zgjatet gjendja e emergjencës.

2. Kushtet e lëshimit, të refuzimit e të heqjes së lejes për kryerjen e kabotazhit, detyrimet e transportuesve e të drejtuesit të mjetit, përmbajtja e dokumentacionit që shoqëron mjetin gjatë kryerjes së kabotazhit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministri përgjegjës për transportin lëshon lejen për kryerjen e operacioneve të kabotazhit.”.

Neni 8

Në nenin 68 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë dhe në shkronjat “b” dhe “c”, fjalët “lejes së transportit” zëvendësohen me fjalën “licencës”.

2. Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) kur transporti i mallrave, kabotazhi, kryhet në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, transportuesi i huaj dënohet:

- i) me gjobë 100 000 deri në 200 000 lekë;
- ii) me heqjen e lejes për kryerjen e kabotazhit.”.

Neni 9

Dispozitë kalimtare

Licencat e lëshuara për shërbimin taksi nga kryetarët e bashkive, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë në fuqi deri në datën e përfundimit të tyre.

Neni 10

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6652, datë 26.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ Nr.10 303, datë 15.7.2010

PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj rregullon organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, më poshtë Agjencia.

Neni 2

Krijimi dhe statusi juridik

1. Krijohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në vijim AIDA.
2. AIDA është person juridik, publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, dhe drejtohet nga bordi drejtues.
3. AIDA vepron për përmbushjen e qëllimeve të saj, në bazë të parimeve të përcaktuara në këtë ligj, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me statutin e saj.

Neni 3

Financimi

1. Burimet e financimit të Agjencisë janë:
 - a) Buxheti i Shtetit/nënprogram i veçantë në buxhetin e ministrisë që mbulon ekonominë;
 - b) të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e saj dhe donacionet.
2. Agjencia, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të ofrojë shërbime dhe të realizojë të ardhura, në funksion të qëllimit e të veprimtarisë së saj.

Neni 4

Administrata e Agjencisë

1. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të Agjencisë i nënshtrohen legjislacionit shqiptar të punës. Emërimi i punonjësve të Agjencisë kryhet në bazë të procedurave konkurruese, të miratuara në statut.

2. Nivelet e pagës dhe të shpërblimeve të punonjësve të Agjencisë miratohen nga bordi drejtues, në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi për pagat për administratën publike.

KREU II FUSHA E VEPRIMIT

Neni 5 **Veprimtaria e Agjencisë**

1. Veprimtaria e Agjencisë përqendrohet, kryesisht, në këto drejtime:

a) në lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime, duke i ofruar shërbime dhe mbështetje investitorëve ekzistues ose potencialë;

b) në rritjen e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, duke mundësuar rinovimin dhe përmirësimin e produkteve e të shërbimeve, si dhe të teknologjisë që ato përdorin, nëpërmjet ofrimit të mekanizmave që bazohen te rritja e kapaciteteve teknike dhe e aftësive rinovuese;

c) në nxitjen dhe ndihmën ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse e dhënies së asistencës financiare për shoqëritë eksportuese dhe promovimin e eksporteve.

2. Agjencia, në funksion të veprimtarisë së saj, kryen të gjitha veprimet dhe ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe duke ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke ndërmjetësuar e duke bashkëpunuar me investitorët e organet shtetërore.

Neni 6 **Lehtësimi dhe mbështetja e investimeve**

Agjencia, për tërheqjen dhe rritjen e investimeve në Republikën e Shqipërisë:

a) identifikon dhe promovon mundësitë e investimeve në Shqipëri, si dhe zhvillon veprimtari në funksion të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë, në nivel ndërkombëtar;

b) përgatit dhe zbaton dokumentin e politikave 3-vjeçare të promovimit të investimeve, e cila miratohet me vendim të bordit drejtues;

c) përgatit dhe zbaton planin vjetor të veprimit e të marketingut, ku përcaktohen grupet e interesit, të cilëve u drejtohet, sipas sektorëve dhe zonave gjeografike të interesit;

ç) nxit, tërheq dhe mbështet investimet e drejtpërdrejta, nëpërmjet ofrimit të asistencës dhe shërbimeve;

d) ndërton dhe mban një bazë të dhënash, ku ruhen dhe përditësohen informacionet për investitorët e huaj e investimet e tyre, me qëllim identifikimin dhe ndihmën ndaj tyre, si dhe publikon të dhënat zyrtare për investimet e huaja;

dh) kryen funksion këshillimor dhe ofron ekspertizë për mundësitë për realizimin e investimeve, si për investitorët, ashtu edhe për organet e pushtetit qendror dhe vendor;

e) ndërmjetëson në marrëdhëniet ndërmjet investitorëve dhe organeve shtetërore qendrore ose vendore. Me kërkesën e tyre, Agjencia mund të përfaqësojë investitorët e interesat e tyre kundrejt organeve dhe institucioneve shtetërore, me përjashtim të gjykatave të çdo niveli.

ë) krijon dhe zhvillon kapacitetet e nevojshme, me qëllim realizimin e fushatave të marketingut, nëpërmjet metodave tradicionale e moderne, në bazë të praktikave e përvojës më të mirë ndërkombëtare;

f) propozon hartimin e politikave që mundësojnë përmirësimin e klimës së investimeve në vend.

Neni 7

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Agjencia, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme:

a) ndihmon në hartimin dhe zbatimin e politikave e të strategjive të Qeverisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke hartuar, zhvilluar dhe koordinuar programe ose projekte për mundësimin e tyre;

b) ndihmon në hartimin dhe përmirësimin e strategjisë kombëtare të rinovimit dhe të përmirësimit të teknologjisë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;

c) luan një rol kryesor në mundësimin e kësaj strategjie, duke kryer funksionin e organit ekzekutiv, që ofron shërbime të drejtpërdrejta për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe mundëson përmirësimin e kapaciteteve në institucionet dhe agjencitë e tjera, në mënyrë që të sigurohet një funksionim efektiv i sistemit të rinovimit në vend;

ç) bën përpjekje për rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare e për zhvillimin e tyre, falë nxitjes së rinovimit, progresit teknologjik dhe shkëmbimeve të informacionit;

d) siguron të dhëna të nevojshme për bizneset dhe mundëson përhapjen e tyre, nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti shkëmbimi të informacioneve, në të cilin publikohen studime, kërkime dhe analiza tregtare;

dh) promovon rritjen e pranisë së bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe krijimin e lidhjeve e të mundësive të bashkëpunimit me bizneset e huaja, për të ndihmuar rritjen e dimensioneve të tyre edhe në nivel ndërkombëtar;

e) ndihmon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në shfrytëzimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare;

ë) nxit përmirësimin e klimës së biznesit, rritjen e kapaciteteve menaxheriale të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke përshpejtuar futjen e teknologjisë së informacionit e të komunikimit, si dhe përmirësimin e prodhimit në nivel ndërmarrjeje.

Neni 8

Zhvillimi i eksportit

Agjencia, me qëllim zhvillimin e eksporteve:

a) promovon produktet dhe shërbimet shqiptare në tregjet ndërkombëtare, për të reklamuar dhe për të lehtësuar eksportin e produkteve “Made in Albania”;

b) ndihmon në hartimin dhe përmirësimin e strategjisë kombëtare të promovimit të eksporteve;

c) mundëson gjetjen e burimeve të reja për eksport në Shqipëri, me synim rritjen e vlerës së shtuar;

ç) krijon një rrjet me organizata partnere dhe specialistë të fushës, me qëllim rritjen e njohjes së tregjeve të përshtatshme për eksport;

d) ofron shërbime mbështetëse dhe u jep asistencë bizneseve private, me qëllim rritjen e volumit të eksportit dhe të nxitjes së aftësive të marketingut për eksport;

dh) ndërmerr veprime konkrete për lehtësimin e investimeve të destinuara për prodhim mallrash dhe shërbime për eksport, duke dhënë mbështetje financiare për shoqëritë eksportuese;

e) bashkëpunon me institucionet publike, financiare, organizatat e biznesit, të vendit dhe të huaja, për të krijuar një sistem shkëmbimi të dhënash, i cili lehtëson lidhjet tregtare dhe krijon mundësitë për shfrytëzimin e hapësirave të reja për shoqëritë e produktet shqiptare për eksport;

ë) organizon konferenca, ekspozita, panairë, si dhe veprimtari të tjera promovionale, me qëllim pjesëmarrjen e ndërmarrjeve shqiptare që prodhojnë mallra dhe ofrojnë shërbime, të destinuara për eksport;

f) identifikon, analizon dhe përllëgarit faktorët që ndikojnë negativisht në eksportet e mallrave e të shërbimeve shqiptare, si dhe propozon hartimin e politikave për uljen e ndikimit të këtyre faktorëve.

Neni 9

Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. Agjencia, gjatë veprimtarisë së saj, ka të drejtë të marrë nga organet e tjera shtetërore, qendrore dhe vendore, të gjithë ndihmën dhe të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve që i janë caktuar.

2. Institucionet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me Agjencinë, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë, për përmbushjen e qëllimeve e të funksioneve gjatë veprimtarisë së saj.

KREU III

ORGANET DREJTUESE TË AGJENCISË

Neni 10

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Agjencisë janë:

- a) bordi drejtues;
- b) kryetari i bordit drejtues;
- c) drejtori ekzekutiv.

Neni 11

Kompetencat e bordit drejtues

Bordi drejtues ka këto kompetenca:

- a) përshtat politikat qeveritare në veprimtarinë e Agjencisë;
- b) propozon politika të reja, si dhe mbikëqyr zbatimin e tyre prej Agjencisë;
- c) miraton statutin e Agjencisë, si dhe aktet më të rëndësishme për organizimin dhe funksionimin e saj;
- ç) miraton buxhetin vjetor të Agjencisë, planet vjetore të biznesit, tarifat e shërbimit, planet e veprimit për zbatimin e strategjive, si dhe kontrollon zbatimin e tyre;
- d) emëron dhe shkarkon drejtorin ekzekutiv, sipas procedurave të përcaktuara në statut, si dhe vendos për çështjet e tjera, të parashikuara në ligj ose në statut.

Neni 12

Përbërja e bordit drejtues

1. Bordi drejtues i Agjencisë përbëhet nga përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të sektorit ekonomik privat.

2. Bordi drejtues i Agjencisë kryesohet nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë dhe ka në përbërje:

- a) ministrin përgjegjës për ekonominë;
- b) ministrin përgjegjës për financat;
- c) ministrin përgjegjës për bujqësinë;
- ç) ministrin përgjegjës për turizmin;
- d) ministrin përgjegjës për punët publike.

3. Anëtarë të bordit drejtues zgjidhen dhe katër përfaqësues nga sektori ekonomik privat. Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e tyre, si dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të bordit drejtues përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13
Vendimet e bordit drejtues

Bordi drejtues mund të marrë vendim vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma anëtarëve. Vendimmarrja e bordit bëhet me konsensus. Në rast se nuk arrihet konsensus, vendimet e bordit drejtues janë të vlefshme kur votojnë pro më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Çdo anëtar gëzon të drejtën e një vote dhe secila votë është e barabartë. Në rast barazimi votash, vota e kryetarit të bordit është vendimtare.

Neni 14
Kryetari i bordit drejtues

1. Kryetari i bordit drejtues thërret dhe drejton mbledhjet e këtij bordi. Kryetari i propozon për miratim bordit drejtues strukturën dhe nivelin e pagave për punonjësit e Agjencisë. Ai mbikëqyr dhe kontrollon realizimin e rregullt të veprimtarisë së Agjencisë, në përputhje me planet vjetore, dokumentet e tjera politike të miratuara nga bordi drejtues, me statutin dhe me këtë ligj.

2. Kryetari i bordit drejtues mund t'ia delegojë kompetencat e tij njërit prej anëtarëve të këtij bordi.

Neni 15
Drejtori ekzekutiv

1. Drejtori ekzekutiv drejton veprimtarinë e përditshme të Agjencisë, në përputhje me këtë ligj dhe me statutin. Drejtori ekzekutiv përfaqëson Agjencinë në marrëdhëniet me të tretët.

2. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, drejtori ekzekutiv informon dhe i raporton, në mënyrë periodike, bordit drejtues. Me kërkesë të secilit prej anëtarëve të bordit drejtues, drejtori ekzekutiv raporton përpara bordit edhe për çështje specifike, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e përditshme të Agjencisë.

Neni 16
Konflikti i interesave

Anëtarët e bordit drejtues, kryetari, drejtori ekzekutiv dhe punonjësit e Agjencisë, në ushtrimin e detyrave dhe të funksioneve të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me statutin, janë të detyruar të veprojnë duke zbatuar rregullat e procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe në aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

**KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE**

Neni 17
Ndryshime në legjislacionin në fuqi dhe shfuqizime

1. Në ligjin nr. 8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, emërtimi “Agjencia Shqiptare e Investimeve dhe Biznesit” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve”.

2. Ligji nr. 9497, datë 20.3.2006 “Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Investimeve dhe Biznesit” shfuqizohet.

3. Asetet kryesore dhe inventari ekzistues i Agjencisë Shqiptare të Investimeve dhe Biznesit kalojnë në administrim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Neni 18
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore, në zbatim të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6653, datë 26.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 305, datë 22.7.2010

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË PËR
SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË
KLASIFIKUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6659, datë 30.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SLLOVENISË MBI SHKËMBIMIN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Sllovenisë, më poshtë referuar si “palët”;

duke rënë dakord për të zhvilluar bisedime për çështjet e sigurisë dhe për të zgjeruar dhe forcuar bashkëpunimin e tyre reciprok;

duke kuptuar që bashkëpunimi i mirë mund të kërkojë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet palëve;

me dëshirën për të siguruar mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer ndërmjet palëve ose ndërmjet subjekteve publike dhe private nën juridiksionin e tyre, në lidhje me interesat dhe sigurinë kombëtare,

kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1 Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje këto tema kanë kuptimet e mëposhtme:

“Informacion i klasifikuar”: çdo informacion, dokument ose material, pavarësisht nga forma e emërtuar dhe e shënuar si e tillë sipas legjislacionit të brendshëm të secilës palë dhe kërkon mbrojtje ndaj zbulimit të paautorizuar, abuzimit ose humbjes.

“Kontratë e klasifikuar”: një kontratë ose nënkontratë, duke përfshirë bisedimet parakontraktuale, që përmban informacion të klasifikuar ose ka të bëjë me aksesin e tij.

“Palë e origjinës”: palë, duke përfshirë çdo subjekt publik ose privat nën juridiksionin e saj, që i jep informacion të klasifikuar palës marrëse.

“Palë marrëse”: palë, duke përfshirë çdo subjekt publik ose privat nën juridiksionin e saj, që merr informacion të klasifikuar nga pala e origjinës.

“Palë e tretë”: një shtet, duke përfshirë çdo subjekt publik ose privat nën juridiksionin e tij, ose një organizatë ndërkombëtare që nuk është palë në këtë Marrëveshje.

“Nevoja për të ditur”: një parim, sipas të cilit mund t’i jepet akses në informacionin e klasifikuar, një individ vetëm në lidhje me detyrat e tij/saj zyrtare.

“Certifikatë sigurie e personelit”: vendimi nga një autoritet kompetent për sigurinë që një individ është i përshtatshëm për akses në informacionin e klasifikuar, në pajtim me legjislacionin e brendshëm.

“Certifikatë sigurie e strukturës”: vendimi nga një autoritet kompetent për sigurinë që një subjekt juridik ka aftësinë fizike dhe organizative për të përmbushur kushtet e përshkruara për trajtimin e informacionit të klasifikuar në pajtim me legjislacionin e brendshëm.

“Kontraktues”: një subjekt publik dhe/ose privat që ka zotësinë juridike për të lidhur një kontratë të klasifikuar.

“Vizitor”: përfaqësues i subjekteve publike ose private nën juridiksionin e një pale, që kërkon të vizitojë ambiente të palës tjetër të angazhuar në aktivitete që përfshijnë informacion të klasifikuar.

Neni 2 Qëllimi dhe objekti

Në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, të dy palët marrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që transmetohet ose prodhohet në pajtim me këtë Marrëveshje.

Neni 3

Autoritetet kompetente për sigurinë

1. Autoritetet e sigurisë kombëtare të caktuara nga palët si përgjegjëse për zbatim në tërësi dhe kontrollet përkatëse të të gjitha aspekteve të kësaj Marrëveshjeje janë:

Në Republikën e Shqipërisë:

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare-NSA).

Në Republikën e Sllovenisë.

Urad Vlade Republike Slovenije za varovanje tajnih podatkov (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare-NSA).

2. Autoritetet e sigurisë kombëtare njoftojnë njëra-tjetrën për çdo autoritet tjetër kompetent për sigurinë që është përgjegjës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

3. Palët informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të mëvonshëm të autoriteteve të sigurisë kombëtare.

Neni 4

Klasifikimet e sigurisë

1. Informacioni i klasifikuar i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje shënohet me nivelin e përshtatshëm të klasifikimit të sigurisë në bazë të legjislacionit të brendshëm të palëve.

2. Barasvlefshmëria e shënimeve të klasifikimit të sigurisë kombëtare është si më poshtë:

Republika e Shqipërisë	Republika e Sllovenisë	Përkthimi anglisht
TEPËR SEKRET	STROGO TAJNO	TOP SECRET
SEKRET	TAJNO	SECRET
KONFIDENCIAL	ZAUPNO	CONFIDENCIAL
I KUFIZUAR	INTERNO	RESTRICTED

Neni 5

Aksesi në informacionin e klasifikuar

1. Aksesi në informacionin e klasifikuar si "I KUFIZUAR" kufizohet për personat që kanë nevojë për të ditur dhe që janë instruktuar përkatësisht.

2. Aksesi në informacionin e klasifikuar si "KONFIDENCIAL" dhe më lart kufizohet për personat që kanë nevojë për të ditur dhe që kanë një certifikatë sigurie të personelit përkatës.

3. Palët njohin bashkërisht certifikatat përkatëse të sigurisë së personelit dhe certifikatat e sigurisë së strukturës. Paragrafi 2 i nenit 4 zbatohet përkatësisht.

Neni 6

Parimet e sigurisë

1. Palët i japin informacionit të klasifikuar të përmendur në këtë Marrëveshje të njëjtën mbrojtje, si edhe informacionit të tyre të nivelit përkatës të klasifikimit të sigurisë.

2. Autoriteti kompetent i sigurisë i palës së origjinës:

a) siguron që informacioni i klasifikuar të shënohet me një shënim të përshtatshëm të klasifikimit të sigurisë në pajtim me legjislacionin e tij të brendshëm dhe

b) informon palës marrëse:

- për çdo kusht të dhënies ose kufizim në përdorimin e informacionit të klasifikuar dhe

- për çdo ndryshim të mëvonshëm në nivelin e klasifikimit.

3. Autoriteti kompetent i sigurisë i palës marrëse:

- a) siguron që informacioni i klasifikuar të shënohet me një shënim klasifikimi të barasvlefshëm në pajtim me paragrafin 2, neni 4;
- b) siguron që niveli i klasifikimit nuk ndryshon, përveç kur autorizohet me shkrim nga pala e origjinës;
- c) përdor informacionin e klasifikuar vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë dhe brenda kufizimeve të caktuara nga pala e origjinës dhe
- d) nuk ia jep informacionin e klasifikuar një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës.

Neni 7

Transmetimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar transmetohet ndërmjet palëve nëpërmjet kanaleve diplomatike ose ushtarake ose nëpërmjet kanaleve të tjera të aprovuara nga autoritetet e tyre kompetente të sigurisë në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm.
2. Informacioni i klasifikuar si i kufizuar mund të transmetohet edhe me postë ose një shërbim tjetër dorëzimi në pajtim me legjislacionin e brendshëm.

Neni 8

Riprodhimi, përkthimi dhe asgjësimi i informacionit të klasifikuar

1. Të gjitha riprodhimet dhe përkthimet kanë shënimet e përshtatshme të klasifikimit të sigurisë dhe ato mbrohen si informacioni i klasifikuar origjinal. Përkthimet dhe numri i riprodhimeve kufizohen në minimumin e kërkuar për një qëllim zyrtar.
2. Të gjitha përkthimet përmbajnë një shënim të përshtatshëm, në gjuhën e përkthimit, duke treguar që ato përmbajnë informacion të klasifikuar të palës së origjinës.
3. Informacioni i klasifikuar me shënimin “tepër sekret” përkthehet ose riprodhohet vetëm me lejen me shkrim të palës së origjinës.
4. Informacioni i klasifikuar me shënimin “tepër sekret” nuk asgjësohet. Ai i kthehet palës së origjinës. Nëse, në rastin e një situatë krize, nuk është e mundur të mbrohet informacioni i klasifikuar me shënimin “tepër sekret” ose t’i kthehet palës së origjinës, ai asgjësohet menjëherë. Pala marrëse njofton palën e origjinës për asgjësimin e informacionit të klasifikuar.
5. Informacioni i klasifikuar si sekret ose më poshtë asgjësohet pasi të mos konsiderohet më i nevojshëm për palën marrëse, në pajtim me legjislacionin e brendshëm.

Neni 9

Kontratat e klasifikuara

1. Nëse autoriteti kompetent për sigurinë e palës së origjinës synon të lejojë bisedime për lidhjen e një kontrate të klasifikuar me një kontraktues nën juridiksionin e palës marrëse, ai, me kërkesë, merr të gjitha certifikatat përkatëse të sigurisë së personelit dhe certifikatat e sigurisë së strukturës nga autoriteti kompetent i sigurisë i palës marrëse.
2. Në rastin e një tenderi të klasifikuar të hapur, autoriteti kompetent i sigurisë i palës marrëse mund t’i japë autoritetit kompetent të sigurisë së palës së origjinës certifikatat përkatëse të sigurisë së personelit dhe certifikatat e sigurisë së strukturës edhe pa një kërkesë.
3. Nënkontraktuesit u nënshtrohen të njëjtave kërkesa të sigurisë si kontraktuesi që ka lidhur kontratën kryesore të klasifikuar.
4. Autoriteti kompetent i sigurisë i palës së origjinës mund të propozojë dhe marrë pjesë në inspektimet e sigurisë që kryhen nga autoriteti kompetent i sigurisë i palës marrëse në ambiente për të siguruar respektimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

Vizitat

1. Vizitat që kërkojnë akses në informacionin e klasifikuar i nënshtrohen lejës paraprake të autoritetit kompetent të sigurisë së palës pritëse.

2. Një kërkesë për vizitë i paraqitet autoritetit kompetent të sigurisë të paktën 20 ditë para fillimit të vizitës. Të dhënat e mëposhtme përdoren vetëm për qëllim të vizitës. Kërkesa për vizitë përmban:

a) emrin, datën dhe vendin e lindjes, shtetësinë dhe numrin e kartës së identitetit/pasaportës së vizitorit;

b) pozicionin e vizitorit, me një specifikim të punëdhënësit që përfaqëson vizitori;

c) një përcaktim të projektit në të cilin merr pjesë vizitori;

d) vlefshmërinë dhe nivelin e certifikatës së sigurisë së personelit, nëse kërkohet;

e) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe faksit, e-mail-in, pikën e kontaktit të strukturës që vizitohet;

f) qëllimin e vizitës, duke përfshirë nivelin më të lartë të informacionit të klasifikuar që përfshihet;

g) datën dhe kohëzgjatjen e vizitës. Në rastin e vizitave të përsëritura, cilësohet periudha e përgjithshme që mbulohet nga vizitat;

h) datën dhe nënshkrimin e autoritetit dërgues kompetent të sigurisë.

3. Në rastet urgjente, autoritetet kompetente të sigurisë mund të bien dakord për një periudhë më të shkurtër të paraqitjes së kërkesës për vizitë.

4. Autoritetet kompetente të sigurisë mund të bien dakord për një listë të vizitorëve të caktuar për vizita të përsëritura. Lista e vlefshme për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj. Një kërkesë për vizita të përsëritura paraqitet në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni. Sapo të aprovet një listë, vizitat mund të planifikohen drejtpërdrejt nga strukturat e interesuara.

5. Çdo informacion i klasifikuar i përfutur nga një vizitor konsiderohet si informacion i klasifikuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Bashkëpunimi i sigurisë

1. Me qëllim që të arrihen dhe ruhen standarde të krahasueshme të sigurisë, autoritetet kompetente të sigurisë, me kërkesë, i japin njëra-tjetrës informacion mbi standardet, procedurat dhe praktikatat e tyre kombëtare të sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Për këtë qëllim, autoritetet kompetente të sigurisë mund të vizitojnë njëra-tjetrën.

2. Autoritetet kompetente të sigurisë informojnë njëra-tjetrën për rreziqet përjashtimore të sigurisë që mund të rrezikojnë informacionin e klasifikuar të dhënë.

3. Me kërkesë, autoritetet kompetente të sigurisë, në pajtim me legjislacionin e brendshëm, asistojnë njëra-tjetrën në zbatimin e procedurave të certifikimit të sigurisë.

4. Autoritetet kompetente të sigurisë informojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo ndryshim në certifikatat e njohura bashkërisht të sigurisë së personelit dhe të sigurisë së strukturës.

5. Shërbimet e sigurisë të palëve mund të shkëmbejnë informacion operativ ose/dhe të fshehtë drejtpërdrejt në pajtim me legjislacionin kombëtar.

6. Bashkëpunimi sipas kësaj Marrëveshjeje do të kryhet në gjuhën angleze.

Neni 12

Shkelja e sigurisë

1. Secila palë njofton menjëherë palën tjetër për çdo ndryshim ose zbulim të një shkeljeje ose kompromentimi të sigurisë së informacionit të klasifikuar.

2. Pala kompetente merr të gjitha masat e përshtatshme të mundshme sipas legjislacionit të saj të brendshëm për të kufizuar pasojat e shkeljes ose kompromentimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni dhe për të parandaluar shkeljet e mëtejshme. Me kërkesë, pala tjetër jep asistencë në hetim, ajo informohet për rezultatin e hetimit dhe masave të marra për shkak të shkeljes.

Neni 13
Shpenzimet

Secila palë mbulon shpenzimet e veta që shkaktohen gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 14
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me konsultime dhe bisedime ndërmjet palëve dhe nuk i paraqitet ndonjë gjykatë ndërkombëtare apo pale të tretë.

Neni 15
Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Ajo i nënshtrohet aprovimit në pajtim me procedurat e brendshme ligjore të palëve dhe hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas marrjes së njoftimit të fundit që kërkesat e nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje janë përmbushur.

2. Kjo Marrëveshje ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin me shkrim të të dy palëve. Këto ndryshime hyjnë në fuqi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Çdo palë ka të drejtën për ta përfunduar këtë Marrëveshje me shkrim në çdo kohë. Në një rast të tillë, vlefshmëria e Marrëveshjes mbaron 6 muaj pas ditës në të cilën merret njoftimi për përfundimin nga pala tjetër.

4. Pavarësisht përfundimit të Marrëveshjes, i gjithë informacioni i klasifikuar i dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje vazhdon të mbrohet në pajtim me dispozitat e përcaktuara, në këtë Marrëveshje derisa pala e origjinës e përjashton palën marrëse nga një detyrim i tillë.

5. Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e palëve që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare.

6. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje mund të vendosen masa zbatuese.

Bërë në Tiranë, më 7.5.2010, në dy kopje orgjinale, në gjuhën sllovene, shqipe dhe angleze, ku secili tekst është njëlloj i barasvlefshëm. Në rast mospërputhjeje në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

VENDIM
Nr.51, datë 22.7.2010

**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR
KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Romeo Gurakuqi emërohet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.52, datë 22.7.2010

**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR
KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Alfred Lako emërohet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.53, datë 22.7.2010

**PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR
KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Nebil Çika emërohet anëtar i Bordit të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.54, datë 22.7.2010

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Zylyftar Bregu zgjidhet anëtar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për një periudhë 5-vjeçare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.55, datë 22.7.2010

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Sami Neza zgjidhet anëtar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për një periudhë 5-vjeçare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.56, datë 22.7.2010

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Suela Musta zgjidhet anëtare e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për një periudhë 5-vjeçare.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 9.8.2010
Doli nga shtypi më 11.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 20 lekë